VENDIM
Nr. 622, datë 15.7.2015

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR MINISTRINË E INTEGRIMIT EVROPIAN, PËR TË MBËSHTETUR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR SHQIPËRI-KOSOVË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr.9936,datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr.160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Integrimit Evro-pian, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Integrimit Evropian, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, në programin "Mbështetja institucionale për procesin e integrimit", zëri "Shpenzime kapitale, kapitulli 04 (TVSH)", t'i shtohet kundërvlefta në lekë e fondit prej 23557.15 (njëzet e tre mijë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë pikë pesëmbëdhjetë) eurosh plus interesa prej 100.38 (njëqind pikë tridhjetë e tetë) eurosh, për përballimin e zbatimit të aktiviteteve mbështetëse të programit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Kosovë.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, i miratuar në buxhetin e vitit 2015.
3. Ngarkohen Ministria e Integrimit Evropian dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama